



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
BORDI**

**VENDIM**

**Nr. 140, Datë 21.08.2020**

**MBI**

**RISHIKIMIN E VENDIMIT TË BORDIT TË ERE-S NR. 86, DATË 12.05.2020, “MBI  
REFUZIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË “SOLARIS POWER” SH.P.K. PËR  
LICENCIM NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE”.**

Në mbështetje të neneve 16, pika 5, të ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar; nenit 4, pika 1, gërma e) dhe nenit 5, pika 1, gërma e) të “Rregullores për Procedurat dhe Afatet për Dhënie, Modifikimin, Transferimin, Rinovimin ose Heqjen e Licencave në Sektorin e Energjisë Elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE 109/2016, i ndryshuar; nenit 16, pika 2, të “Rregullores për Organizimin, Funkcionimin dhe Procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s Nr. 96, 17.06.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 21.08.2020, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 96/8 Prot., datë 17.08.2020 të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikqyrjes, mbi kërkesën e shoqërisë “Solaris Power” sh.p.k. për rishikimin e vendimit të bordit të ERE-s Nr. 86, datë 12.05.2020,

**Konstatoi se:**

- Bordi i ERE-s, me vendimin Nr. 86, datë 12.05.2020, vendosi të refuzojë kërkesën e shoqërisë “Solaris Power” sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për shkak se shoqëria nuk ka kthyer përgjigje dhe nuk e ka plotësuar dokumentacionin e konstatuar të munguar.
- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 447/2 Prot, datë 28.05.2020, shoqëria “Solaris Power”, ka paraqitur kërkesën për rishikimin e vendimit Nr. 86/2020.
- Bashkëlidhur kërkesës për rishikimin e vendimit Nr. 86/2020, shoqëria “Solaris Power” sh.p.k. ka depozituar dhe një pjesë të dokumentacionit të konstatuar të munguar.
- Me shkresën nr. 447/4 Prot, datë 19.06.2020, shoqëria “Solaris Power” sh.p.k. ka kërkuar zgjatjen e afatit me 10 ditë të tjera për depozitim të këtij dokumentacioni.
- Me vendimin Nr. 110, datë 02.07.2020, Bordi i ERE-s vendosi të zgjasë me 30 (tridhjetë) ditë afatin e shqyrtimit të kërkesës të shoqërisë “Solaris Power” sh.p.k., për rishikimin e vendimit të bordit të ERE-s Nr. 86, datë 12.05.2020, “Mbi refuzimin e kërkesës të shoqërisë “Solaris Power” sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”. Shoqëria u njoftua për këtë vendimarrje të Bordit, me shkresën e ERE-s nr. 447/5 Prot, datë 17.07.2020.

- Me shkresën e datës 10.08.2020, protokolluar në ERE me nr. 447/6 Prot, datë 17.08.2020, shoqëria është shprehur se pamundësia dhe vështirësia e pajisjes me të gjithë dokumentacionin e kërkuar nga ana e ERE-s ka ardhur si pasojë e situatës së krijuar për shkak të pandemisë COVID-19.
- Dokumentacioni i nevojshëm për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike kryesisht i plotësuar nga ana e shoqërisë.

Dokumentacioni që rezulton i plotësuar pjesërisht apo i pa plotësuar është si më poshtë:

- **Formati dhe dokumentacioni për aplikim**

- **Neni 9, pika 1**

- gërma a) (të dhënat për aplikimin). Plotësuar pjesërisht.
    - gërma b) (të dhëna identifikuese për aplikuesit). Plotësuar pjesërisht.
    - gërma c) (të dhëna për aplikuesin). Plotësuar pjesërisht.

- **Dokumentacioni teknik për veprimtarinë tregtimit të energjisë elektrike**

- **Neni 9, pika 4.8**

- gërma “a” (Sasia e energjisë elektrike e parashikuar për t’u tregtuar në GWh sipas viteve). Pa plotësuar.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s,

**Vendosi:**

1. Të pranojë kërkesën e shoqërisë “Solaris Power” sh.p.k. për rishikimin e vendimit të bordit të ERE-s Nr. 86, datë 12.05.2020, “Mbi refuzimin e kërkesës së shoqërisë “Solaris Power” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
2. Pika 1 e vendimit të bordit të ERE Nr. 86, datë 12.05.2020, ndryshon dhe bëhet:
  1. Të licencojë shoqërinë “Solaris Power” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar, me kusht që:
    - a. Brenda 3 (tre) muajve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, shoqëria “Solaris Power” sh.p.k. të depozitojë në ERE dokumentacionin e munguar, si më poshtë:
      - i. Formatin me të dhënat për aplikim, sipas kërkesave të gërmave “a”, “b” dhe “c” të nenit 9, pika 1, të rregullores, të plotësuar sipas formatit të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s Nr.109/2016, i ndryshuar;

- ii. Informacionin përkatës në lidhje me sasinë e energjisë elektrike të parashikuar për t'u tregtuar në GWh sipas viteve.
  - b. Shoqëria të mos fillojë ushtrimin e veprimtarisë së licencuar pa plotësuar dokumentacionin e munguar.
- 3. Pas pikës 1, shtohet pika 2 me këtë përmbajtje:
  - 2. Ky vendim është objekt rishikimi në rast se shoqëria nuk plotëson dokumentacionin e munguar në afatin e përcaktuar.
- 4. Drejtoria Juridike dhe Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve, të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**

**Petrit AHMETI**